



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KUVENDI
KOMISIONI HETIMOR
PËR HETIMIN E SHKELJEVE TË RËNDA KUSHTETUESE NGA PRESIDENTI I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDIM I NDËRMJETËM

Nr. 4, datë 14.05.2021

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË HETIMIT

Bazuar në nenin 15, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, Komisioni Hetimor

VENDOSI:

1. Miratimin e planit të hetimit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

ALKET HYSENI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI HETIMOR
PËR HETIMIN E SHKELJEVE TË RËNDA KUSHTETUESE NGA PRESIDENTI I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PLANI I HETIMIT

Në mbështetje të nenit 13, pika 2, të nenit 14, shkronja “ç”, të nenit 15, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe në planin paraprak të hetimit të miratuar nga Komisioni me vendimin e ndërmjetëm nr. 2, datë 8.5.2021, Komisioni vendosi të miratojë Planin e Hetimit, i cili në përputhje me objektin e hetimit, përmban hapat proceduralë dhe veprimet hetimore që do të ndiqen nga komisioni për hetimin e çështjes.

I. FAKTET DHE RETHANA

1. Presidenti i Republikës gjatë periudhës përpara dhe gjatë fushatës zgjedhore, si dhe në ditën e heshtjes zgjedhore 2021 ka kryer akte dhe deklarata të cilat në mënyrë të përmbledhur janë renditur si më poshtë vijon:

28 Prill 2020: “Kërcënimi i fundit, që vjen përmes Tao Taos, nga bandat e Elbasanit dhe të gjithë Shqipërisë ka vetëm një përgjigje: Presidenti, gati për të firmosur Dekretin për mbrojtjen e Republikës! Shqipëria e Shqiptarëve! Vdekje tradhëtarëve!”

24 Prill (dita e heshtjes zgjedhore): “Të dashur Prokurorë dhe Gjyqtorë! Dëgjojeni mirë Presidentin e Republikës! Boll dëgjuat përfaqësuesin e Ndrangheta-s, Don Agaçion. Nëse jo, një pikë gjaku të derdhet nesër, por edhe një pikë loti, mjerë ju! Nesër duhet të jetë Festa e Demokracisë!”

24 Prill (dita e heshtjes zgjedhore): “Kriminelët janë kudo të rrezikshëm. Por më të rrezikshmit janë kriminellët e veshur me uniformë, janë ata që gjenden brenda sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë. Prandaj thirrini mendjes, zbatoni ligjin, qëndroni larg ndikimeve politike, mos u bëni palë dhe ruani integritetin e detyrës. Përmbushni detyrën pa asnjë vonesë dhe mos e detyroni Popullin t’ju arrestojë në flagrancë përmes ligjit, që Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar. Presidenti i Republikës është gjithmonë me Kushtetutën dhe Sovranin. Presidenti i Republikës është gjithmonë gati për të marrë përgjegjësinë për çdo Dekret në mbrojtje të Zgjedhjeve, Demokracisë dhe Popullit nga dhuna e oligarkisë! Nesër duhet të jetë Festa e Demokracisë.”

24 prill (dita e heshtjes zgjedhore): “Cfurqet do jenë të dielën nëse preket vota. Zgjedhje si të Shijakut dhe të Dibrës, nuk do të ketë më. Kjo histori ka marrë fund. Unë kam besim të shqiptarët. Të gjithë janë nisur drejt kutive të votimit, për të sjellë ndryshimin historik duke çuar Shqipërinë në rrugën e duhur.”

20 prill: "Lidheni të Marrin shokë socialistë përpara se të ketë fatin e furgonit në Berat. Pse Meta u tha tre banditëve të "Rilindjes" të hynin në zyrën elektorale të PD dhe të qëllonin me armë Sekretarin demokrat? Me kë janë në këtë foto këta të katërt? Me Metën apo me Kryebashkiakun e emëruar rilindas të Kavajës dhe shtabin e tij elektorale? Pse Meta e porositi Damjanin publikisht të përsërisë "tërmetin" e Dibrës në Vlorë? Pse Meta emëroi një ushtri patronazhistësh për të survejuar e shantazhuar 900 mijë qytetarë të Qarkut Tiranë? Kush e prishi Marrëveshjen e 5 Qershorit nga tmerri i zgjedhjeve të lira? Bablok, shqiptarët e dinë shumë mirë se ku kurdisesh ti për t'i përçarë shqiptarët në Shqipëri dhe rajon. Me qetësi dhe vendosmëri do e marrësh përgjigjen më 25 Prill nga të gjithë shqiptarët patriotë dhe europianë. Dhe në radhë të parë nga socialistët, që u shkatërrove çdo vlerë pozitive dhe njerëzorë. Unë do shkoj në shtëpi kur ti të shkosh në psikiatri! Shqipëria e shqiptarëve! Shqipëria në Bashkimin Europian! Pas 25 Prillit kjo rrugë nuk ndalet më asnjë sekondë!"

19 prill: "Bravo qytetarëve të Beratit! Gjejini! Izolujini! Mos i toleroni! Nuk ka patronazhist, fuks dhe bandit, që mund ta ndalë Ndryshimin e Madh më 25 Prill! ..Ngrehumi dhe bjeruni, korini dhe shtypini, katundar e punëtorë, që nga Shkodra gjer në Vlorë! Me qetësi dhe vendosmëri drejt 25 Prillit!"

13 prill: "Gropat e zeza të inceneratorëve të mafies, i thithën 100 përqind paratë e planifikuara për financim nga taksapaguesit në 2020, ndërkohë që pjesa tjetër e projekteve të menaxhimit të mbetjeve shfaqin realizim të dobët, që shkon deri në 9%. Prandaj 25 Prilli është referendum popullor kundër mafies së inceneratorëve e plehrave dhe kandidatëve të saj."

11 Mars: "Kërkoj nga çdo qytetar shqiptar të tregojë respekt për veten dhe të besojë që fuqia e tij në demokraci është vota. Erdhi koha t'ia kthejmë Edin, Lindës dhe Zahos, të cilëve ju mungon aq shumë."

1 Mars: "Detyra e qytetarit është të votojë. Unë i them qytetarit kush ju ka bërë presion me vendin e punës, kush ua ka blerë votën, ndëshkoheni me votë. Unë nuk kam asnjë interes, as se çfarë ka thënë dhe çfarë thotë njëri apo tjetri. Me 26 prill ma ndërroni emrin, ma vendosni si të doni nëse një votë vidhet, do u pritët dora në sheshin Skënderbe, Kryemadhit të parit dhe të tjerat. Ky është një premtim i presidentit të këtij vendi. Nëse ka një bandit që do të tentojë të bëjë blerjen e votave si Shijak dhe Dibër do ua pres unë dorën, unë presidenti i Shqipërisë. Një votë të vidhet do të pritët një votë, nuk është në kuptimin figurativ."

24 shkurt: "Ç'kapja e shtetit është nevojë ulëritëse për të ardhmen europiane të Shqipërisë dhe për të ndalur shpopullimin e saj. Demokracia është kontrolli i sovranit mbi të zgjedhurit dhe jo zgjedha e oligarkisë mbi qytetarët dhe dhunimi i të drejtave të tyre kushtetuese. Dëshmova sot përballë qytetarëve të Republikës një rast flagrant të kapjes së shtetit nga sektin në pushtet me urdhër të Kryeoligarkut në pushtet, që ka kapur çdo institucion publik dhe tmerrohet nga zgjedhjet e lira dhe rivendosja e llogaridhënies demokratike. U bëj thirrje të gjithë deputetëve të reflektojnë për këtë koncesion sa më parë!"

20 shkurt: "Janë të shqetësuar nga mesazhet e Presidentit?! Le TË SHQETËSOHEN dhe le TË TMERROHEN të gjithë ata, të cilët mendojnë se do bëjnë "tërmet" në zgjedhje, si në Dibër, apo si në Shijak, qofshin këta qeveritarë, punonjës policie; qofshin banditë, gjithçka qofshin."

2. Duke vlerësuar se aktet e kryera nga Presidenti janë shkelje të rënda dhe flagrante të Kushtetutës, 49 deputetë të Kuvendit kërkojnë shkarkimin e tij në përputhje me nenin 90, pika 2 të Kushtetutës. Kjo dispozitë shprehimisht thotë: "(...) 2. Presidenti i Republikës mund të

shkarkohet për shkelje të rëndë të Kushtetutës dhe për kryerjen e një krimi të rëndë. Propozimi për shkarkimin e Presidentit në këto raste mund të bëhet nga jo më pak se një e katërta e anëtarëve të Kuvendit dhe duhet të mbështetet nga jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij”.

Shkaqet për të cilat kërkohet shkarkimi i Presidentit është kryerja prej tij e shkeljeve të rënda dhe flagrante kushtetuese.

3. Kërkuesit pretendojnë se Presidenti i Republikës para, gjatë dhe pas periudhës së fushatës zgjedhore të vitit 2021, me veprimet, sjelljet dhe mesazhet e dhëna në publik, nuk ka garantuar unitetin kombëtar, nuk ka moderuar konfliktin politik, por përkundrazi e ka nxitur atë në terma të tilla të cilat sollën si pasojë daljen e organizuar të militantëve të partive politike në rrugë, duke terrorizuar qytetarët, duke kufizuar lirinë e tyre të lëvizjes, si dhe lirinë personale, deri në kryerjen e konflikteve me armë dhe humbjen e jetës së një personi dhe plagosjen e disa të tjerëve, përfshirë vënien në rrezik të jetës së efektivëve të Policisë së Shtetit..

4. Kërkuesit pretendojnë se qartësisht Presidenti ka kryer veprimtari të njëanshme partiake, kundër mazhorancës, e cila bie ndesh me vullnetin e hartuesve të Kushtetutës shqiptare, të cilët në nenin 89 parashikojnë në një dispozitë ndaluese se “*Presidenti i Republikës nuk mund të mbajë asnjë detyrë tjetër publike, nuk mund të jetë anëtar partie dhe as të kryejë veprimtari tjetër private*”. Në këtë mënyrë sipas kërkuesve, Presidenti ka rrëzuar cdo mundësi për t’u konsideruar si përfaqësues i “unitetit kombëtar”, që nënkupton se Presidenti është i të gjithë popullit, pa iu referuar ndonjë orientimi politik të caktuar dhe se në vendimarrjen përkatëse nuk duhet të mbajë kahje politike. Ndryshe nga ky përcaktim, Presidenti i Republikës u paraqiti si person partiak dhe me akte dhe veprime në kundërshtim me këtë dispozitë kushtetuese ndaluese, mbajti qartësisht anën e opozitës parlamentare, pasi rezultoi nga cdo dalje apo mesazh i tij publik

5. Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore 2021 Presidenti i Republikës, sipas kërkuesve, ka kryer në mënyrë të përsëritur disa akte dhe sjellje të cilat përbëjnë shkelje të rënda dhe flagrante të Kushtetutës dhe shkak për ndasi sociale-politike. Aktet e Presidentit konsistojnë në sjellje dhe mesazhe publike të tij në kundërshtim me parimin e unitetit të popullit, të papajtueshme me cilësinë e Kreut të Shtetit dhe rolin e tij kushtetues si përfaqësues i unitetit të popullit, të përcaktuar në nenin 86, pika 1 të Kushtetutës.

6. Kërkuesit në kërkësen e tyre për shkarkimin e Presidentit të Republikës, pretendojnë se me akte të përsëritura Presidenti i Republikës ka shkelur rëndë detyrimet kushtetuese që burojnë nga neni 88, pika 3, të Kushtetutës, për të cilat Presidenti i Republikës ka kryer betimin përpara Kuvendit se *do t’i bindet Kushtetutës dhe ligjeve të vendit, do të respektojë të drejtat dhe liritë e shtetasve, do të mbrojë pavarësinë e Republikës së Shqipërisë dhe do t’i shërbejë interesit të përgjithshëm dhe përparimit të popullit shqiptar*.

7. Presidenti i Republikës, sipas kërkuesve, nëpërmjet akordimit pa asnjë procedurë të titujve dhe dekoratave, apo dhënies së shtetësisë shqiptare për persona të cilët nuk përmbushin kriteret ligjore, apo nuk kanë kaluar nëpër procedurat e kontrollit ligjor, ka kryer veprime të cilat janë në kundërshtim me kompetencat kushtetuese të tij, konkretisht në kundërshtim me nenin 94 të Kushtetutës që përcakton se “*Presidenti i Republikës nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera përveç atyre që i njihen shprehimisht me Kushtetutë dhe që i jepen me ligje të nxjerra në pajtim me të*”.

8. Mesazhet publike të Presidentit të Republikës një ditë para ditës së votimit, e rregulluar ligjërisht si dita e heshtjes zgjedhore, në respekt të së drejtës kushtetuese të individëve për të zgjedhur, intervistat e tij të shpeshta, në mediat print, audiovizive apo mediat elektronike, mesazhet ditore në rrjete sociale, të mbushura me etiketime ndaj figurave të larta shtetërore, mesazhet denigruese ndaj përfaqësuesve të lartë të misioneve diplomatike në Shqipëri, sipas kërkesve, kanë cënuar rëndë të drejtat kushtetuese të individëve, imazhin dhe reputacionin e vendit dhe marrëdhëniet me partnerët strategjike të Shqipërisë.

II. OBJEKTI DHE DETYRAT E KOMISIONIT

Bazuar në vendimin e Kuvendit nr. 45/2021 “Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit “Për hetimin e shkeljeve të rënda kushtetuese nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë”, objekti i punës së komisionit hetimor është:

- a) Hetimi dhe verifikimi nëse aktet kryera dhe deklaratat e dhëna nga Presidenti i Republikës gjatë periudhës përpara dhe gjatë fushatës zgjedhore, si dhe në ditën e heshtjes zgjedhore 2021 përbëjnë shkelje të rëndë të Kushtetutës.
- b) Verifikimi i pasojave të këtyre akteve në raport me parimin e unitetit të popullit, prishjen e ekuilibrit politik, të qetësisë publike, nxitjen e urrejtjes dhe dhunës, vënien në rrezik të jetës së njerëzve, ndërhyrjen dhe intimidimin e institucioneve publike, dëmtimin e imazhit dhe reputacionit të vendit, si dhe marrëdhëniet me partnerët strategjikë të Shqipërisë.
- c) Verifikimi i akteve, sjelljeve dhe qëndrimeve të caktuara të Presidentit të Republikës, në raport me rolin dhe pozitën e tij kushtetuese.

Në zbatim të objektit të punës, detyra e Komisionit është :

1. Verifikimi i mënyrës së ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore nga ana e Presidentit të Republikës gjatë periudhës përpara dhe gjatë fushatës zgjedhore, si dhe në ditën e heshtjes zgjedhore 2021.

Për të realizuar objektivat dhe detyrën për të cilën është ngritur, Komisioni Hetimor do të ndërmarrë një sërë veprimesh procedurale në përputhje me përcaktimet në ligjin nr. 8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si: pyetje dëshmitarësh, kërkesa për marrje informacione ose dokumenta zyrtare, caktim eksperti, si dhe do të administrojë dhe do të shqyrtojë gjithë dokumentacionin që do t’i vihet në dispozicion nga institucionet.

III. HAPAT PROCEDURIALE QË DO TË NDIQEN NGA KOMISIONI DERI NË PËRFUNDIM TË HETIMIT

Hapat procedurale që do të ndiqen deri në përfundim të hetimit janë:

1. Seancë dëgjimore me Presidentin e Republikës, në zbatim të nenit 112, pika 3 të Rregullores së Kuvendit.
2. Administrimi dhe shqyrtimi i informacioneve, të dhënave, raporteve të marra nga institucionet lidhur me objektin e hetimit.
3. Administrimi i raportit të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut “Për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për nisjen e

procedurës së shkarkimit nga detyra të Presidentit të Republikës, z. Ilir Meta”, datë 6.5.2021.

4. Administrimi i kërkesës së një grupi deputetësh për shkarkimin nga detyra të Presidentit të Republikës, z. Ilir Meta”, datë 30.04.2021.
5. Administrimi i opinionit të ekspertit/ëve konstitucionalistë.
6. Administrimi i çdo dokumenti tjetër për të cilat Komisioni vihet në dijeni dhe e gëjkon të arsyeshme t’i administroje, gjatë punës së tij.
7. Diskutim në lidhje me gjetjet e Komisionit Hetimor sipas objektit të hetimit.
8. Marrja e vendimeve sipas rregullave të përcaktuar në ligjin nr. nr. 8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit” si dhe rregullores së Komisionit Hetimor.
9. Përgatitja dhe miratimi i raportit përfundimtar së bashku me mendimin e pakicës;
10. Paraqitja në Kuvend për miratim të raportit përfundimtar.

IV. DOKUMENTET QË DO TË SHQYRTOHEN NGA KOMISIONI

Komisioni Hetimor gjatë veprimtarisë së tij do të administrojë dhe shqyrtojë dokumentet e mëposhtme:

1. Informacioni i dërguar nga Autoriteti i Medias Audiovizive lidhur me deklaratat e dhëna nga Presidenti i Republikës në mediat e shkruara si dhe kasetat filmike të mesazheve dhe deklaratave të dhëna nga Presidenti i Republikës në mediat audiovizive lidhur me objektin e hetimit të këtij Komisioni.
2. Informacioni i dërguar nga Bashkia Tiranë lidhur me procedurat e kryera prej saj gjatë ekzekutimit të lirisë të ambjenteve të zyrave të Partisë Fryma e Re Demokratike, aktet përkatëse, si dhe informacioni mbi ndërhyrjen dhe veprimet e kryera nga Presidenti i Republikës lidhur me këtë çështje.
3. Informacioni i dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit lidhur me objektin e hetimit të Komisionit.
4. Informacioni i dërguar nga Prokuroria e Përgjithshme lidhur me veprat penale apo kallëzimet e regjistruara të lidhura me zgjedhjet për periudhën e fushatës zgjedhore 2021.
5. Informacioni i dërguar nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar lidhur me veprat penale apo kallëzimet e regjistruara të lidhura me zgjedhjet për periudhën e fushatës zgjedhore 2021.
6. Informacioni i dërguar nga Shërbimi Informativ i Shtetit lidhur me objektin e hetimit të Komisionit.
7. Informacioni i dërguar nga Institucioni i Presidentit të Republikës lidhur me titujt/dekoratat e akorduara nga Presidenti i Republikës, personat që u janë akorduar si dhe procedurat e akordimit dhe dhënies së tyre, aktivitetet protokollare, vizitat si dhe takimet e organizuara, nga Zyra e Presidentit me individë, institucione apo subjekte të ndryshme në të cilat ka qenë pjesëmarrës Presidenti, për periudhën objekt të hetimit.
8. Raporte të institucioneve ndërkombëtare.
9. Raporti i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut “Për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të Presidentit të Republikës, z. Ilir Meta”, datë 6.5.2021.

10. Dokumentat e tjerë për të cilat Komisioni vihet ne dijeni dhe/ose e gjykon të arsyeshme t'i administrojë gjatë punës së tij.
11. Opinioni i ekspertëve konstitucionalistë të caktuar me vendim të Komisionit, në lidhje me mënyrën e ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore nga ana e Presidentit të Republikës gjatë periudhës përpara dhe gjatë fushatës zgjedhore, si dhe në ditën e heshtjes zgjedhore 2021.
12. Në kuadër të analizës së plotë mbi objektin e hetimit, Komisioni Hetimor do të thërrasë për të dëshmuar Presidentin e Republikës dhe do të administrojë e shqyrtojë deklaratimet e tij në seancën degjimore.
13. Procesverbali i seancës degjimore me Presidentin e Republikës.

V. AFATI I ZHVILLIMIT TË HETIMEVE DHE PËRFUNDIMIT TË TIJ:

Veprimet	Afati maksimal
Administrimi dhe shqyrtimi i informacioneve, të dhënave, raporteve të marra nga institucionet lidhur me objektin e hetimit.	Datë 17.05.2021
Seanca degjimore me Presidentin e Republikës	Datë 18.05.2021
Shqyrtimi përfundimtar dhe nxjerrja e konkluzioneve të hetimit – Mbyllja e Hetimit	Datë 20.05.2021
Prezantimi i Raportit Final të Komisionit	Datë 24.05.2021

Hetimi konsiderohet i hapur dhe Komisioni do të përfundojë veprimtarinë e tij brenda afatit të caktuar me vendim të Kuvendit nr. 45/2021 “Për ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit “Për hetimin e shkeljeve të rënda kushtetuese nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë”.

KRYETARI

ALKET HYSENI